



REPUBLIKE E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKCA OF KOSOVO  
Kuvendi Komunal Dragash - Skupstina Opštine Dragaš - Municipality of Dragash

- Kuvendi Komunal  
01 Nr. 06-2805/3  
Dt.25.02.2014.  
Dragash

Në bazë të nenit 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 8.1 dhe 2 të Ligjit për përdhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të komunës nr.04/L-144 dhe nenit 2 të Rregullores të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.23/2013, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.25.02.2014, miraton këtë:

## V E N D I M

**I. THEMELOHET** Komisioni Vlerësues i ofertave të pronës së paluajtëshme të Komunës së Dragashit të karakterit afashkurtër dhe afatgjatë, në këtë përbërje 7 anëtarësh: 3 anëtarë nga Kuvendi Komunal, 3 nga ekzekutivi i Komunës-Dragash dhe 1 anëtar nga shoqëria civile, si vijon:

1. Sherif Aga, delegat i KK-së, nga "Vakat-i",
2. Halim Shemsidini, delegat i KK-së, nga LDK-ja,
3. Granit Rifaj, delegat i KK-së, nga PDK-ja,
4. Islam Rexhepllar, jurist i dip.-komuna-Dragash,
5. Ramadan Krasniqi, jur. i dip.-komuna-Dragash,
6. Xhevat Isufi, gjeodet-komuna-Dragash, dhe
7. Jeton Qengaj, Qendra Rinore(SHC)-Dragash.

**II.** Mandati i Komisionit zgjat deri me mandatin e Kuvendit, përkatësisht deri sa mos të vendoset ndryshe nga Kuvendi.

**III.** Anëtarët e Komisionit, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin e Komisionit i cili kryeson punën e Komisionit.

**IV.** Komisioni për hapat e ndërmarr e njofton Kuvendin Komunal dhe kryetarin e Komunës-Dragash.

**V.** Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

### *Arsyetim*

Duke u bazuar në kërkesat e subjekteve fizik e juridik për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të Komunës, Kuvendi Komunal i Dragashit, pas shqyrtimit paraprak në seancën e KK-së të dt.25.02.2014, miraton Vendimin si në pikën I të këtij Vendimi.

Detyrë e Komisionit është të merret me vlerësimin e rasteve të adresuara organeve të Komunës, përkatësisht Kuvendit Komunal i cili, pas ankandit-konkursit publik dhe vlerësimit të Komisionit, merr Vendim paraprak për propozimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtëshme të Komunës, dhe, me shumicë votash të anëtarëve të Kuvendit, aprovohet oferta e përzgjedhur nga Komisioni.

I dërgohet: - Anëtarëve të Komisionit..., dhe  
- Arkivit



Kryesuesi  
Shaban Shabani